



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/264
Datë: 09.07.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 263-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/264
Datë: 09.07.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet buxhetore për mbështetje të Këshillit Kombëtar Shqiptar në vlerë prej 580,000.00€ (pesëqindetëdhjetë mijë euro) për bashkëfinancimin e projektit "Ndërtimi i Shkollës së Muzikës dhe Muzeut të Preshevës".
2. Për zbatim të këtij Vendimi, mjetet merren nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nënprogrami "Përkrahje për Luginën e Preshevës" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi do të transferohen në llogari bankare, në emër të Këshillit Kombëtar Shqiptar, HALKBANK Iban: RS 35155007040000131481.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/264
Datë: 09.07.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 1,245,122.00€ (një milion e dyqindedyzetepesë mijë e njëqindnjëzetedy euro) në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) me kod 221, nënprogrami "Administrata Qendrore" me kod 11321, nga kategoria e investimeve kapitale, konkretisht nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782, në dhjetë (10) projekte kapitale, në pajtim me marrëveshjet e mirëkuptimit për bashkëfinancim të projekteve të nënshkuara nga Ministri i Zhvillimit Rajonal dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti i investimit kapital "Programi për Zhvillim Rajonal", me kod 18782, në këto projekte, me shumatat e cekura si në vijim:
 - 2.1. Projekti "Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosovë" - Komuna e Dragashit, në shumë prej 130,000€ (njëqindetridhjetë mijë euro);
 - 2.2. Projekti "Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh" - Komuna e Ferizajt, në shumë prej 100,000€ (njëqindmijë euro);
 - 2.3. Projekti "Renovimi i objektit të NPI. "Stacioni i Autobusëve" në Gjakovë, Faza II", - Komuna e Gjakovës, në shumë prej 100,000€ (njëqindmijë euro);
 - 2.4. Projekti "Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë" - Komuna e Hanit të Elezit, në shumë prej 90,122€ (nëntëdhjetëmijë e njëqindnjëzetedy euro);
 - 2.5. Projekti "Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jashanicë, si dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan" - Komuna e Klinës, në shumë prej 100,000€ (njëqindmijë euro);
 - 2.6. Projekti "Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë" - Komuna e Mitrovicës së Jugut, në shumë prej 150,000€ (njëqindpesëdhjetë mijë euro);
 - 2.7. Projekti "Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik" - Komuna e Podujevës, në shumë prej 50,000€ (pesëdhjetëmijë euro);
 - 2.8. Projekti "Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit - Komuna e Prizrenit, në shumë prej 150,000€ (njëqindpesëdhjetë mijë euro);
 - 2.9. Projekti "Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza III" - Komuna e Shtimes, në shumë prej 150,000€ (njëqindpesëdhjetë mijë euro);
 - 2.10. Projekti "Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës për shumë qëllime - Faza II" - Komuna e Mamushës, në shumë prej 225,000€ (dyqindnjëzetepesë mijë euro).

3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/264
Datë: 09.07.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për Grantin për Përgatitjen e Projektit "Programi - Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit, Faza II (FLOWS2)".
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/264
Datë: 09.07.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për transfer të mjeteve buxhetore, në shumë prej 712,215€, (shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorisë së shpenzimeve "Investime kapitale", për mbulimin e obligimeve, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet MKRS-së dhe Federatës së Volejbollit, Komitetit Olimpik të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale" nga nënprogramet si në vijim:
 - 2.1. Nënprogrami "Agjencia për Zhvillimin e Rinisë", me kod 83100, nga projekti "Qendra Multifunkionale në Ferizaj", me kod 18373, në shumë prej 399,840€ (treqind e nëntëdhjetë e katër dhjetë euro), transferi është -24.99% të ndarjes së ndikuar negativisht, në total të nënprogramit në kategorinë e shpenzimeve të "Investimeve kapitale".
 - 2.2. Nënprogrami "Biblioteka Kombëtare", me kod 90900, nga projekti "Renovimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës", me kod 14227, në shumë prej 312,375€ (treqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë euro), transferi është -24.99% të ndarjes së ndikuar negativisht, në total të nënprogramit në kategorinë e shpenzimeve të "Investimeve kapitale".
3. Mjetet nga pika 2. e këtij Vendimi transferohen në nënprogramin "Sportet e Gjera", me kod 80100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere", në shumë prej 712,215€ (shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro).
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/264
Datë: 09.07.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23, paragrafi 1. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178 të datës 13.12.2022, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178 të datës 13.12.2023, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241 të datës 27.12.2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 2,000,000.00€ (dy milionë euro), për zbatimin e masës 1.9 – Mbështetja e punësimit të personave nga komunitetet jo-shumice të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, me kod 211, në nënprogramin "Administrata Qendrore" me kod 11311, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në nën-programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë